

## Elite Raund/ Kombetarja U-17 meson kundertshtaret

nga AlbaniaSoccer

E premte, 29 Nentor 2013 00:02

---



Ne Nyon te Zvicres është hedhur edhe shorti kualifikues për Europeanin U-17 që do të zhvillohet në Maltë në vitin 2014. Shqipëria pasi u kualifikua per nete kete nivel elitar, synon te bej gjera te medha edhe pse pasi pa skuadrat kundertshtare qe i rezervoit shorti, kuptoi se do te jete e veshtire. 17 vjecaret e talentuar do te perballen me skuadra te forta dhe shancet per te vazhduar me tej jane te vogla. Angli, Cekia dhe Italia jane skuadrat me te cilat do te garojne kuqezinjte e drejtuar nga Xhemal Mustedanagic. Nje short vrases ky qe ka merzitur trajnerin boshnjak qe shpresonte per dicka me mire. “Elite Raund” do te zhvillohet ne Republikën Ceke, me datat 26,28 dhe 31 mars te vitit 2014.